

Prishtinë me 16/11/2020

Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi dhe Rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Naser Sahiti sot nënshkruan Memorandumin e Bashkëpunimit në mes të dy Institucioneve. Në ceremoninë e nënshkrimit pas Ministrisë Kuçi dhe Rektorit Sahiti ishin prezent edhe Prorektorja Albulena Blakaj-Gashi, Dekani i Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë Bedri Dragusha dhe iniciatorja e memorandumit, Blerta Mehmedi-Kastrati. Ministri dhe Rektori u dakorduan për nevojën e përcaktimit të modaliteteve të bashkëpunimit në mes Ministrisë dhe Universitetit të Prishtinës-Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë në fushën e mbrojtjes së vlerave natyrore dhe zhvillimit të qëndrueshem për mbrojtjen e mjedisit dhe faunës, ekspertizës dhe kërkimeve shkencore për projekte mjedisore.

Me këtë rast ministri Kuçi tha se qëllimi i këtij memorandum është të krijojë lidhje bashkëpunimi ndërmjet Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", gjegjësisht Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë dhe ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.

Sot kam kënaqësinë që si Ministër së bashku me Rektoren ta nënshkruajmë një marrëveshje e cila është iniciativë e hershme lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe të ecim përpara. Këto kanë të bëjnë me kërkime të ndryshme shkencore, praktikës së studentëve të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë. Ndërsa Rektori i dëshiroj suksese në punën e tijë sidomos, Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë në lëmitë përkatëse të mjedisit", ka thënë ministri Kuçi.

Ndërsa, rektori Sahiti u shpreh se me nënshkrimin e këtij memorandum, punimet në fushën e mjedisit do të kenë mundësi që të vihen në pah më shumë.

"Kam kënaqësinë që në cilësinë e rektorit të UP-së, të nënshkruaj këtë Memorandum Bashkëpunimi ku me zgjerimin e fushave dhe përgjegjësisive të MEA-së na është hapur mundësia për bashkëpunim duke pas parasysh që fusha e mbrojtjes së mjedisit është një ndër top temat sot jo vetëm në Kosovë por gjithandej. Me këtë marrëveshje do të kemi mundësinë që stafi i UP-së të jap një kontribut të çmueshëm me ekspertizën dhe analizat e tyre në mbrojtje të ambientit dhe faunës dhe punimet të kenë rezultate", shtoi rektori Sahiti.

Ky memorandum do të krijojë kushte të përgjithshme për bashkëpunimin dy palësh në sferën e arsimit dhe kërkimit në shërbim të bashkëpunimit në zhvillimin e moduleve dhe programeve mësimore në nivelin bachelor dhe master, realizimin e punës praktike për studentet në këto module dhe programe, shkëmbimet e përvojave, praktikave të mira, ekspertëve dhe literatures përkatëse për zhvillimin institucional, me qëllim të avancimit të politikave në fushën e mjedisit dhe planifikimit hapësinor e veprimtarive shkencore dhe profesionale, ndikimi pozitiv në përafrimin e programeve të studimit me nevojat e tregut të punës e shumë veprimtari të tjera.

Për mbarëvajtjen e memorandumit janë caktuar edhe dy koordinator.

Nga ana e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit është caktuar z. Vullnet Luzhnica, ndërsa koordinatore nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë është caktuar znj. Blerta Mehmedi-Kastrati.



